



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:225822

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05993142

P.nr.207/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Valon Hajdini, me bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe procesmbajtësi- praktikanti Hisen Kabashi, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.A. për veprat penale: Kanosja nga neni 181 par.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP-II.nr.1481/21, të datës 11.10.2021, në prezencën e palëve, Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë Arjan Xhema, të dëmtuarit H.A., të pandehurit B.A. si dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.Ibrahim Berisha. Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, publik, më 08.05.2024, kurse ka shpallur publikisht aktgjykimin më datë 10.05.2024, ndërsa më dt.07.06.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.A. nga i ati M., nëna H., e vajzerisë A., i lindur më datë [data e lindjes...], në fshatin..., Komuna Skenderaj, me vendbanim në rrugën..., në Mitrovicë, me numër personal [numri i leternjoftimit...], shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i pesë (5) fëmijëve, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 15.08.2021, rreth orës 11:00 në rrugën... në fshatin..., Komuna Skenderaj, seriozisht me përdorim të armës dhe mjetit të rrezikshëm kanosi, se personin tjetër do t'i shkakton ndonjë të keqe, me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit, në atë mënyrë që në oborrin para

shtëpisë se vallit të tij-të dëmtuarit H.A., në prani të fëmijëve të mitur, shau, ofendoi dhe me pas e kërcënoi viktimën se do t'i dëboi nga shtëpia, kështu që shkoi drejt tij me një thikë kuzhine të gjatë 11 cm, në një dorë dhe me një shat në dorën tjetër, me ç' rast shkaktoi tek i dëmtuari frikë dhe ankth.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve:1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 46,47, 48, 49, 69, të KPRK-së, nenin 364, 365 dhe nenit 449 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, të pandehurit B.A., i

SH Q I P T O N

I.DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht që i pandehuri brenda periudhës kohore prej (2) dy viteve, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale të natyrës të njëjtë, apo më të rëndë.

II.I pandehuri B.A. obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumë prej 20 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej dyzet (40.00) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Lidhur me kërkesën pasurore juridike, pala e dëmtuara H.A., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP-II.nr.1481/21, të datës 11.10.2021, ndaj të akuzuarit B.A., me vendbanim në rrugën..., në Mitrovicë, për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale me datë 29.01.2024, 04.03.2024 dhe datë 08.05.2024, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, i cili ka qenë i hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar Prokuroi i

shtetit Arjan Xhema, i dëmtuari H.A., i pandehuri B.A. si dhe i tij me autorizim av.Ibrahim Berisha.

Gjykata në këtë çështje penale, në shqyrtimin gjyqësor me datë 29.01.2024 me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të Prokurorit të shtetit ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit-të dëmtuarin H.A. si dhe dëshmitarin B.A. si dhe ka administruar provat materiale si në vijim : Raportin e oficerit policor i datës 12.08.2021, Raportin fillestar të incidentit i datës 15.08.2021, Procesverbalin mbi marrjen në pyetje për të dëmtuarin H.A. të dhënë në fazën fillestare të hetimeve i datës 15.08.2021, Procesverbalet mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B.A. të dhënë në fazën fillestare të hetimeve i datës 15.08.2021, Procesverbalet mbi marrjen në pyetje të të pandehurit – B.A. të dhënë në fazën fillestare të hetimeve i datës 15.08.2021, Vertetimi mbi konfiskimin e pasurisë i datës 15.08.2021, Foto Albumi gjithsej pesë (5) faqe i datës 15.08.2021 si dhe veshtrimi në të gjitha shkresat e lëndës.

- Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit Arjan Xhema përgjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2024 ka dorëzuar me shkrim fjalën përfundimtare ashtu që ka deklaruar se, pas administrimit të provave në mënyrë bindëse u vërtetua se i pandehuri B.A. ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.4 të KPRK-së, mohimi kategorik i të pandehurit se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet nuk u vërtetua me asnjë rrethanë faktike dhe juridike, gjendja faktike u vërtetua me provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, e të cilën me se miri e ka vërtetuar deklarata e të dëmtuarit H.A.e cila në detaje e ka përshkruar veprimin inkriminues të pandehurit i cili kishte kanosur të dëmtuarin H., në prani të fëmijëve duke sharë dhe ofenduar dhe me një thikë ka shkuar në drejtim të tij dhe po ashtu në dorë ka pas edhe një shati, me ç’ rast të i njëjti ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe të pasigurisë, po ashtu nga deklarimi i dëshmitarit B.A., i cili në shqyrtim gjyqësor në mënyrë të qartë ka përshkruar se si ka ndodhur ngjarja ku ditën kritike kishte qenë brenda në shtëpi dhe i kishte dëgjuar fëmijët duke bërtitur dhe kur ka dalë jashtë në oborr e ka parë të pandehurin me një shati dhe një thikë të vogël në dorë, ka vërejtur se distanca mes babait të tij dhe të pandehurit B. ka qenë e afërt dhe ka konstatuar se B. i ka kërcënuar me thikë dhe shati babain e tij, fëmijët dhe gruan e babait, tutje ka theksuar se gjendja faktike vërtetohet edhe nga raportet policore të cilat konfirmojnë se në vendngjarje policia kishte gjetur një thikë afër veturës së të pandehurit e po ashtu në oborin e shtëpisë ishte edhe shati të cilin i pandehuri e kishte përdorur për të kanosur i cili është sekuestruar nga Policia e Kosovës, i pandehuri në polici kishte mohuar kryerjen e veprës penale, deklarata e të pandehurit është konfuze dhe e paqartë dhe është

bërë në drejtim të ikjes se përgjegjësisë penale dhe minimizimit të pasojave të veprës penale andaj, i propozoi gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethanë rënduese të marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes, vlera e mbrojtur, kurse si rrethanë lehtësuese të marr parasysh se i pandehuri ka qenë korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e mbështetë deklarin e prokurorit të shtetit, kurse sa i përket kërkesës pasurore juridike të njëjtën nuk e kërkojë dhe hoqi dorë nga ajo, sa i përket çështjeve tjera i lë gjykatës që të vendosë.

Mbrojtësi i të pandehurit përgjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2024 ka dorëzuar me shkrim fjalën përfundimtare ashtu që ka deklaruar se, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale të cilën prokuroria e ka përfshirë në aktakuzë e mbi bazën e së cilës e ka akuzuar të pandehurin B.A., vetëm mbi bazën e supozimeve, thashethemeve pa arritur të vërtetojë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka mundur të kryej veprën penale Kanosja pasi që nga veprimet e të akuzuarit nuk mundë të vërtetohet se ai ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, se fjala hyrëse e prokurorit të shtetit është në kundërshtim të plotë me dispozitivin e aktakuzës, ku fuqishëm mbrojtja ka paraqitur argumentet në fjalën hyrëse se prokuroria nuk ka arrite përtej dyshimit të bazuar mirë të paraqet arsyet dhe faktet se mbi cilën bazë ka ngritur aktakuzën në drejtim të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.4 të KPKR-së, se në seancën e shqyrtimit është bërë dëgjimi i të dëmtuarit H.A., nga deklarata e tij nuk mohohet se atë ditë i pandehuri B., ka shkuar afër shtëpisë se tij duke parkuar veturën si herave të tjera dhe aty posa e ka vërejtur i dëmtuari H., menjëherë ka dalë dhe përveç bisedave të cilat janë zhvilluar në mes dy vëllezërve nuk mohohet fakti se B. nga nervoza ka mundur të shaj dhe të bërtas, për arsye se me parë ka qenë i provokuar nga H., duke ja dëmtuar veturën e cila ishte e parkuar afër pronës se B.A. dhe përveç sharjeve dhe britmave nuk ka pasur ndonjë pretendim tjetër siç theksohet në aktakuzë, ngase sharjet, fyerjet e britmat nuk kanë të bëjnë me vepër penale siç prokuroria ka pretenduar, ndërsa nga deklarata e dëshmitarit B.A. i cili të dëmtuarin e ka baba, ndërsa të pandehurin B. e ka agjë dhe nga deklarata r tij dhënë në shqyrtim gjyqësor shihet se vetëm ka dëgjuar bisedat mes tyre per arsye se në ato momente ka qenë brenda në shtëpi për arsye se kishte musafir dhe nuk ka dëgjuar fjalë kërcënuese që B. ju ka drejtuar babait të tij. Tutje ka theskuar se nga e tërë kjo që u tha me lartë mungon lidhja shkak – pasojë duke munguar dashja direkte për të kryer

I pandehuri B.A. përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare u deklarua i pafajshëm lidhur veprën penale për të cilën akuzohet ndërsa, ka deklaruar se e mbështet në terësi deklarin e të mbrojturit të tij po ashtu e njoftojë gjykatën se gjendjen shëndetësore nuk ka ka të mirë, përdorë tre herë në ditë terapi për asmë (bronhid) po ashtu përdorë terapi të cilën ia ka caktuar neoropsikiatri ku ëdo ditë nga dy hapa, po ashtu ka lëndime në kokë e të cilat e kanë rënduar gjendjen e tij shëndetësore.

Pas administrimit të provave, i akuzuari u njoftua me të drejtat e tij nga neni 319 par.2 të KPP-së në cilësinë e palës së akuzuar në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 04.03.2024, ashtu që deklaroi se në këtë çështje penale shfrytëzon të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje.

-Provat e prezantuara

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit H.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor datë 29.01.2024 ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë deklarimeve të dhëna në polici, ndërsa lidhur me ditën kritike ka deklaruar se i kujtohet se data ka qenë 15.08.2021 mëngjes, para shtëpisë sime në fshatin..., atë ditë ka pasur musafir, i pandehuri rreth orës 09:30 apo 10 në mëngjes ka ardhë me veturë si edhe herëve të tjera në oborrin e shtëpisë sime, fëmijët e djemve të mijë kanë qenë në oborr, B. ka filluar me sha dhe bërtite sikurse herëve të tjera, duke u drejtuar me fjalët pse nuk po e vret atë personin që ta ka goditur gruan e djalit me veturë, i pandehuri me ka shajtur me nënë, me ka thënë se je shpiun, millosh, distanca ka qenë afërsisht dy metra afër shtëpisë dhe me thikë në dorë dhe me një sopat i ka njëkë fëmijët dhe ju ka thënë se me këtë thik kam me ju pre, fëmijet kanë hyrë brenda në shtëpi duke bërtitur, atëherë shoqes sime i ka thënë se ma theve (dëmtove veturën).

Prokurori i shtetit me lejen e gjykatës ka ballafaquar dëshmitarin me fotografit nga vendi i ngjarjes dhe atë fotot nga fotoalbumi i datës 15.08.2021 faqe nr.1, dëshmitari ka deklaruar se kjo ka qenë thika që B. ka pasur në dorë dhe kjo ka qenë një thikë kuzhine, dhe në foton me numër të faqes 3 është oborri im, vendi ku ka ndodhur ngjarja, nuk e di se cila është arsyeja e këtij konfliktit B. edhe me herët ka ardhur në oborr të shtëpisë ka shajtur dhe ka thënë se keni me dalë prej këtu sepse kam me ju mbytë të gjithëve, ka ardhur dhe ka shllajfit me kerr para disa ditëve datës sakt nuk e di, me ka goditë me boks, mi ka ther dhëmbët para derës se shtëpisë, jam frikësuar shumë për fëmijët e po ashtu jam ndjerë shumë keq.

Me B. kam jetuar në bashkësi familjare njëzet vite dhe gjatë asaj kohe nuk kemi pasur probleme, bashkësinë familjare e kemi shkëputur në vitin 1990, B. në fshatin... ka tokë dhe ka një shitore, B. e kemi përjashtuar nga rrethi familjar që prej vitit 2008, ndërsa kur ka hyrë B. në oborr fëmijët kanë qenë para shtëpisë duke luajtur në oborr, B. në... vjen vetëm për probleme.

Dëshmitari B.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor datë 29.01.2024 ka deklaruar se sa i përket kësaj çështje penale dëshiroj që të dëshmojë edhe përkundër faktit se jam i liruar nga detyrimi për të dëshmuar, se mbetem në tërësi pranë deklaramëve të dhëna në polici, ndërsa lidhur me ditën kritike ka deklaruar se, data e sakt nuk me kujtohet por dita dhe ora po, rasti ka ndodhur përafërsisht pas orës 11:00, në oborrin tonë në fshatin..., sa i përket ngjarjes unë vetëm kam dëgjuar fëmijët e mijë duke bërëtitur pasi që kam qenë brenda me musafir dhe kam dalë në oborr, i kam marrë fëmijët dhe e kam vërejtur se B. në dorë e ka pas një si shati të vogël dhe një thikë në dorë ka vazhduar duke shajtur dhe fyer në përgjithësi familjen tonë, ndërsa në oborr ishte babai me gruan e tij njerkën time, kur kamë dalë në oborr nuk ka qenë distanca e afërm, pasi që prindi ka qenë duke u larguar nga B. dhe kam vërejtur se B. në dorë ka pasur një shati dhe një thikë. Prokurori i shtetit i ka vënë në vështrim fotoalbumin e datës 15.08.2021, fotot nga faqja nr.1 dhe 2, gjithsejtë 11 fotografi se a është kjo thika që ju e keni parë në dorë B., e po ashtu a është ky shati në faqen numër 2 të këtij fotoalbumi, i njëjti ka deklaruar se, për shati jam i sigurt që është ky siç është fotografuar, ndërsa për thikë nuk jam i sigurt për arsye se thikën në dorë është e vështir për ta identifikuar pasi që distanca ime ka qenë shumë e largët.

Prokurori i shteti me lejen e gjykatës i ven në vështrim fotografit nga fotoalbumi i datës 15.08.2021 dhe atë foto nga faqja numër 3 dhe 4 gjithsej 10 fotografi, dëshmitari deklaroi se ky është oborri i shtëpisë sime, vendi ku ka ndodhur ngjarja, ndërsa arsyeja që i kamë marrë fëmijët dhe i kamë futur brenda në shtëpi ishte se fëmijët ishin të frikësuar nga fjalët dhe britmat që i kishte përdorur B. Në ballafaqimin me deklaratën e dhënë në polici me datë 15.08.2021, faqja nr.2 rendi numër 4 , “ u ardhë djali i vëllait i cili është 7 ose 8 vjeç, erdh duke qajtur se B. është duke e kërcënuar me thikë dhe me një shati në dorë, fëmijët, babain tim, vëllaun dhe gruan e babës (njerkën time), ka deklaruar se po kjo është deklarata ime që kam dhënë në polici dhe mbetëm pranë saj.

Mbrojtësi i të pandehurit me lejen e gjykatës e ka ballafaquar dëshmitarin me deklaratën e dhënë në polici me datë 15.08.2021, në faqën numër 2 rendi 7, me fjalët “ unë menjëherë kam dal jashtë

i kam thënë vëllaut dhe babait tim, kryejeni punën e juve dhe mos u merrni me të”, ka deklaruar se, po unë i kam thënë këto fjalë. Në pyetjen e gjyqtarit të vetëm gjykues se ju deklaruar se B. ka hyrë në oborrin tuaj me thikë dhe me shati në dorë a mund të na përshkruani fjalët që i ka thënë B. babait tuaj, ka deklaruar se unë kam dalë me vonë në vendin e ngjarjes dhe nuk kam dëgjuar fjalë nga ana e B. t; i jetë drejtuar babait tim, gjykata ka ballafaquar dëshmitarin me deklaratën e dhënë në polici me datë 15.08.2021, faqe numër 2 rreshti 9 “ndërsa ai xhahai B. vazhdonte duke fyer dhe kërcenuar dhe shkonte në drejtim të vëllait dhe babës me thik dhe shati në dorë” cila është e vërteta kjo që po deklaroni tani apo ajo që keni deklaruar në polici me datë 15.08.2021, dëshmitari ka deklaruar se e vërteta është kjo që kam deklaruar në polici.

-Vlerësimi i gjykatës

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve, dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale të lartë cekura, në kuptim të nenit 360 par.2 të KPP-së me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku nga të cilat gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij akgjykimi.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe deri në fjalën përfundimtare vërtetoi se nuk ishte kontestuese si i pandehuri B.A. më datën 15.08.2021 në fshatin... në rrugën..., me përdorimin një shati (mjet i punës) dhe thikës me gjatësi të tehut 11cm kishte kanour vëllaun e tij të dëmtuarin H.A., në prezencën e familjarëve të tij.

Gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar duke u mbështetur në deklarin e të dëmtuari-dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu edhe në deklarin e më hershëm në polici, ku kemi një lidhshmëri dhe konsistence në mes të këtyre deklarimeve dhe nuk kemi ndryshime substanciale, që do të vënin në dyshim kredibilitetin e të dëmtuari- dëshmitari, e po ashtu të njëjtat deklarime gjejnë mbështetje në provat tjera që gjenden në lëndë, andaj gjykata ia falë besimin.

-Vlerësimi i provave

Me administrimin e provave dhe duke i vlerësuar ato secilën veç e veç dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata gjeti se i akuzuari B.A. është fajtor për veprën penale me të cilën akuzohet.

Nuk është kontestuese për gjykatën se i akuzuari B.A., me të dëmtuarin H.A. edhe më herët kanë pasur mosmarrëveshje mes tyre si pasojë ndarjes së trashëgimisë, kjo vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuarit H.A. dhënë në polici, më datë 15.08.2021, i cili deklaron se më datë 15.08.2021 rreth orës 10:40 min, vëllau im B.A., nga Mitrovica ka ardhur në oborrin tim në fshatin... ku më ka shajtur “ta qifsha nënën dhe duke më thënë shpiun dhe millosh”, fëmijët kanë qenë në oborr, Bislimi ka vrapuar me një thikë të bukës në dorë dhe me një shati të mallterit fëmijët janë friksuar kanë piskatur dhe më pas kanë dal dhe të tjerët djem dhe familja përjasht dhe problemi që e kemi me vëllaun tim është kontest pronësor.

Gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar duke u mbështetur në deklarimin e të dëmtuarit-dëshmitar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu edhe në deklarimin e më hershëm në polici dhe deklarimin e dhënë në polici, ku kemi një lidhshmëri dhe konsistence në mes të këtyre deklaramëve dhe nuk kemi ndryshime substanciale, që do të vënin në dyshim kredibilitetin e të dëmtuarit- dëshmitarit, e po ashtu të njëjtat deklaramë gjejnë mbështetje në provat tjera që gjenden në lëndë, andaj gjykata ia falë besimin.

Po ashtu këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarimi i dëshmitarit B.A. në deklaratën e dhënë në polici më datë 15.08.2021 e po ashtu në seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 29.01.2024 ka deklaruar se është njoftuar nga djali i vëllait se ka ardhur B. me shati dhe me thikë në dorë dhe po i kërcënon fëmijët, babanë tim vëllaun dhe njerken time, kam dal jashtë dhe e kam parë B. duke sharë kërcënuar me fjalë dhe shkonte në drejtim të vëllaut dhe babës me thikë dhe me shati në dorë, menjëherë e kam njoftuar policinë dhe ai u zbraps.

Andaj gjykata deklarimit të dëshmitarit B.A. ia falë besimin dhënë në polici dhe para gjykatës pasi që ku kemi një lidhshmëri dhe konsistence në mes të këtyre deklaramëve dhe nuk kemi ndryshime substanciale, që do të vënin në dyshim kredibilitetin dëshmitarit, e po ashtu të njëjtat deklaramë gjejnë mbështetje në provat tjera që gjenden në lëndë, andaj gjykata ia falë besimin.

Po ashtu një gjendje të tillë faktike gjykata e vërteton edhe nga foto albumi që gjendet në shkresat e lëndës i përpiluar më datë 15.08.2021, ku në vështrim të fotografive të bëra në vendin e ngjarjes vërehet thika e sekuestruar me të cilën i pandehuri B.A. e kishte kanosur vëllaun e tij B.A., e po

ashtu vërehet shati (mjeti i punës) ku në ditën kritike e kishte pasur në dorë i pandehuri B.A., me të cilën e kishte kanosur tani të dëmtuarin.

I pandehuri B.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore të mbrohet në heshtje, kurse në deklarin e dhënë në polici më datë 15.08.2021, i njëjti ka mohuar kryerjen e veprës penale me pretendimet se është palë e dëmtuar dhe i është uzurpuar shtëpia e tij, këto deklarime të tij nuk përputhen me gjendjen faktike të njëjtat janë dhënë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Nuk është kontestuese se në ditën kritike të pandehurit B.A. i ishte dëmtuar vetura, kjo shihet edhe nga foto albumi i datës 15.08.2021, mirëpo sa i përket kësaj çështje e njëjta nuk përbënte objekt e as subjekt të aktakuzës, andaj gjykata nuk mund të gjykoj përtej aktakuzës së paraqitur nga prokurori i shtetit.

Po ashtu neni 359 paragrafi.1 përcakton se *“Aktgjykimi mund t’i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor”*

Nga elaborimi i provave është vërtetuar gjendja faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ashtu që me veprimet e të akuzuarit B.A. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale : Kanosa nga neni 181 par.4 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek i akuzuari ka ekzistuar dashja direke që veprën penale ta kryej në mënyrën e përshkruar si ne dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe është pajtuar që të shkaktohet pasoja e ndaluar.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

-Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 69 të KPK-se. Kështu si rrethane lehtësuese për të pandehurin gjykata ka vlerësuar faktin i njëjti është baba i pesë (4) fëmijëve, është i moshës së shtyer, gjendjen shëndetësore e ka të rënduar, vuan nga asma (bronhiti) ku përdpr terapi mjekësore, po ashtu gjendet nën terapi mjekësore të neurologut, ka edhe sëmundje të tjera përcjellëse, andaj një dënim i shqiptuar me burgim ndaj të pandehurit do të kishte pasoja negative në shëndetin e tij, kurse si rrethanë rënduese në rastin konkret gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre janë të shprehura e në të tendencë të rritjes së tyre, i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra të tjera penale me aktgjykimet, P.nr.96/2005 i plotfuqishëm me datë 06.05.2011 dhe P.nr.259/2017 i plotfuqishëm me datë 03.04.2021, sipas Njoftimit të Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve të kësaj Gjykate, njoftuar përmes e-mail adresës elektronike datë 09.05.2024 verifikuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me nenin 38 të KPK-së, me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë të përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike nuk ka vendosur pasi që pala e dëmtuar H.A. ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike në fjalën përfundimtare më datë 08.05.2024.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nen par. 2.6 të KPPK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në shumën prej (20) njëzet euro dhe (20) njëzet në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në total prej (40) katërdhjetë euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 dhe 369 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.207/2021 të datës 07.06.2024.

Procesmbajtësi

Hisen Kabashi

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Valon Hajdini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë në kopje të mjaftueshme për gjykatën.